



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Financave

Raporti fiskal mujor

Janar-Maj 2011

Qershor, 2011

TABELA E PËRMBAJTJES

Treguesit kryesore fiskale per periudhen janar-maj 2011.....	2
Analiza e te ardhurave per periudhen janar - maj 2011.....	2
Vështrim i përgjithshëm.....	2
Të ardhurat sipas taksave, tatimeve dhe burimeve të tjera.....	3
Taksimi i konsumit (indirekt)	3
Taksimi direkt	7
Analiza e shpenzimeve per periudhen janar-maj 2011	12
Vështrim i përgjithshëm.....	12
Shpenzimet korrente.....	13
Shpenzimet e personelit.....	13
Shpenzimet për interesa	14
Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes	15
Shpenzimet për subvencione	15
Shpenzimet për fonde speciale	15
Shpenzimet të pushtetit lokal	16
Pagesa e papunësisë.....	16
Shpenzimet kapitale.....	17

TREGUESIT FISKALË KRYESORË PËR PERIUdhËN JANAR-MAJ 2011

Nga të dhënat e Thesarit të Ministrisë së Financave, për pesëmuajorin e parë të vitit 2011 të ardhurat totale në buxhetin e konsoliduar arritën në 129.8 miliardë lekë (shih tabelen 1). Të ardhurat totale buxhetore ishin 5.4 përqind më të ulëta së parashikimi dhe 0.8 përqind më të larta se një vit më parë. Shpenzimet totale arritën në 150.5 miliardë lekë (shih tabelën 1), 1.8 përqind më të ulëta së planifikimi dhe 9.6 përqind më të larta se një vit më parë. Shpenzimet korrente janë rritur mbi baza vjetore me 8.8 përqind, ndërsa shpenzimet kapitale me 9.9 përqind.

Deficiti fiskal, i llogaritur si diferenca e të ardhurave me shpenzimet gjithsej të buxhetit të konsoliduar, arriti në këtë pesëmuajor në 20.4 miliardë lekë, 4.4 miliardë lekë më shumë se planifikimi, dhe 12.7 miliardë më i lartë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Deficiti është financuar në pjesën më të madhe me burime të brëndshme (kryesisht huamarrje): 162 milionë lekë janë të ardhurat nga privatizimi të destinuar për financimin e deficitit; 21.7 miliardë lekë të ardhurat nga huamarrja e brendshme neto. Financimi i huaj neto i deficitit ka qenë në nivelin 2.5 miliardë lekë, 5.6 miliardë më pak se planifikimi.

Tabela 1. Treguesit kryesorë të buxhetit të konsoliduar për periudhen janar-maj

Miliardë lekë	Janar-Maj '10	Janar-Maj '11	Planifikimi 2011
TE ARDHURAT TOTALE	128.7	129.8	137.2
SHPENZIMET TOTALE	136.4	150.5	153.2
Nga të cilat: SHPENZIMET KORRENTE	112.1	122.1	118.1
Nga të cilat: SHPENZIMET KAPITALE	25.7	28.2	33.3
BALANCA FISKALE	-7.7	-20.4	-16.0
BALANCA PRIMARE	+7.9	-5.3	+0.5

ANALIZA E TË ARDHURAVE PËR PERIUdhËN JANAR - MAJ 2011**Vështrim i përgjithshëm**

Të ardhurat e buxhetit të konsoliduar për periudhën 5-mujore arritën në 129.8 miliardë lekë, 5.4 përqind më pak se parashikimi dhe 0.8 përqind më shumë se një vit më parë. Të ardhurat nga tatimet dhe doganat u realizuan në masën 92.5 përqind ndaj parashikimit, ose rreth 89.5 miliardë lekë nga 96.8 miliardë lekë të planifikuara, duke shënuar një rritje prej 4.9% kundrejt një viti më parë; të ardhurat nga pushteti vendor arritën në 6 miliardë lekë nga 6.4 miliardë lekë të planifikuara në buxhetin e 2011 ose rreth 232 milion lekë më tepër se një vit më parë; të ardhurat në fondet speciale arritën 23.5 miliardë lekë nga rreth 24.1 miliardë lekë të planifikuara, ose rreth 22.4 miliardë të realizuara një vit më parë, me rritje vjetore prej 5 përqind; të ardhurat nga ndihmat për këtë periudhë rezultojnë 865 milionë lekë nga rreth 2.4 miliard lekë të parashikuara ose nga rreth 1.4 miliardë lekë të një viti më parë; të ardhurat jo-

tatimore kanë qënë për këtë periudhë 9.9 miliardë lekë nga 13.9 miliardë të një viti më parë, më rënie vjetore 28.3 përqind.

Sipas agjencive të mbledhjes, administrata doganore ka mbledhur 45 miliardë lekë, 8.4 përqind më pak se parashikimi, me rritje prej 1.1 përqind kundrejt 5-mujorit të 2010. Sipas zërave të të ardhurave që mbledhin doganat, bie në sy performanca e rentës minerare në eksport, që është rritur me rreth 65 përqind, kryesisht si pasojë e rritjes së eksporteve të burimeve natyrore si dhe ndryshimeve në normën e taksimit dhe në strukturën e taksës gjatë gjysmës së parë të vitit 2011. Të ardhurat nga akciza në doganë rezultojnë me rënie prej 14.8 përqind kundrejt një viti më parë. Të ardhurat nga TVSH në import janë 3.5 përqind më të larta se një vit më parë dhe 8.8 përqind më pak se parashikimi ose rreth 3.3 miliardë lekë më pak.

Të ardhurat në Dogana sipas muajve dhe krahasimi me 2010

Dogana total 2011	Muaji (miliardë lekë)	Në % ndaj muajit paraardhës	Në % ndaj 2010
Janar	8.1	-34.3	13.4
Shkurt	8.2	1.3	9.9
Mars	9.5	16.2	-3.4
Prill	9.4	-1.3	-3.6
Maj	9.9	5.3	-4.8

Administrata tatimore ka mbledhur 9 përqind më shumë të ardhura se 5-mujori i 2010. Kjo administratë ka shënuar performancë të mirë në mbledhjen e tatim fitimit, akcizës, tatimin mbi të ardhurat personale dhe taksave nacionale për 5-mujorin, por ka regjistruar një rënie në mbledhjen e TVSH..

Të ardhurat në Tatime sipas muajve dhe krahasimi me 2010

Tatime total 2011	Muaji (miliardë lekë)	Në % ndaj muajit paraardhës	Në % ndaj 2010
Janar	9.0	-2.8	7.0
Shkurt	7.8	-13.9	8.4
Mars	10.7	37.6	17.0
Prill	7.7	-28.0	-4.1
Maj	9.2	19	15

Të ardhurat sipas taksave, tatimeve dhe burimeve të tjera

Taksimi i konsumit (indirekt)

Nga TVSH janë mbledhur gjithsej për 5-mujorin 44.2 miliardë lekë, ose 0.6 përqind më pak se një vit më parë. Të ardhurat e mbledhura janë 14.6 përqind më pak se parashikimi në buxhet.

Nga Administrata Doganore janë mbledhur 33.7 miliardë lekë TVSH mbi importin, duke realizuar planin e periudhës në masën 91.2 përqind. Të ardhurat nga TVSH-ja në doganë përbëjnë rreth 76 përqind të të ardhurave gjithsej nga TVSH-ja. Ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ato rezultojnë të jenë 1.1 miliardë lekë më shumë ose 3.5 përqind më shumë. Të ardhurat nga TVSH në doganë ndikohen direkt nga vlera e importeve (volumet e importuara, çmimet në import dhe kursi i kembimit). Sipas të dhënave të INSTAT për tregtinë e jashtme gjatë 5-mujorit të parë të 2011, importet në vlerë janë rritur me 15.5 përqind kundrejt një viti më parë të ndikuara edhe nga rritja e çmimeve në import për mallrat kryesore ushqimore në tregjet ndërkombëtare ndërsa efekti i kursit të kembimit ka qënë i pandjeshëm. Kontributin më të lartë për rritjen e importeve për 5-mujorin e kanë patur këta artikuj: minerale, lëndë djegëse; materiale ndërtimi dhe metale; makineri pajisje dhe pjesë këmbimi.

Në tabelën më poshtë pasqyrohen të dhënat mbi vlerën e importit për 5-mujorin të makineri-pajisje për vitet 2007-2011, për të cilat aplikohet shtyrja e TVSH-së në import për një vit ose më shumë.

Kapitulli	2007	2008	2009	2010	2011
84 (makineri, pajisje)	12,039	13,134	16,634	12,510	17,542
85 (makineri, pajisje)	7,755	12,137	13,454	12,556	13,665
87 (mjete transporti)	9,965	10,070	11,089	9,988	8,935
Total	29,758	35,341	41,178	35,054	40,142
Rritja në %		18.76%	16.52%	-15%	14.52%

Nga administrata tatimore për periudhën Janar - Maj janë mbledhur 44.4 miliardë lekë nga 47.6 miliardë lekë të planifikuara, ose 6.6 përqind më pak. Të ardhurat nga TVSH-ja në tatime përbëjnë rreth 24 përqind të të ardhurave gjithsej nga TVSH-ja. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2010, të ardhurat nga TVSH-ja në tatime janë ulur rreth 1.4 miliardë lekë, ose me 11.7 përqind.

Rimbursimi i TVSH-së për periudhën 5-mujore ka arritur shifrën 2.7 miliardë lekë nga 2.2 miliardë që ishte një vit më parë, me rritje 22 përqind. Kjo shpjegon rreth 15.6 % të mosrealizimit të planit të TVSH nga mosrealizimi total për të ardhurat nga kjo taksë.

Nga të dhënat e TVSH-së së paguar sipas sektorëve (që i referohet pesë mujorit) vihet re se ka rënie të TVSH-së së paguar nga ndërtimi (me -33.2 përqind) dhe shërbimet (me -21.15 përqind) kundrejt një viti më parë, për një total prej 1.4 miliardë lekë më pak për pesë-mujorin. Ndërkohë, sektori i prodhimit rezulton me 24.5 përqind më shumë TVSH të paguar, duke rritur kontributin e këtij sektori në totalin e TVSH-së së paguar. Në total të ardhurat nga këto sektorë kanë pësuar një ulje prej 11.7% duke e krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në të njëjtën kohë teprica kreditore totale e TVSH për 4-mujorin e vitit 2011 rezulton të jetë 32.1 miliardë lekë.

Në tabelën në vijim paraqitet gjëndja e teprices kreditore sipas sektorëve për periudhën 2008-2011

Teprica Kreditore	(Miliardë lekë)	(Miliardë lekë)	(Miliardë lekë)	(Miliardë lekë)
KREDIA	12-mujori 2008	12-mujori 2009	12-mujori 2010	4-mujori 2011
Tregëti	-19.3	-23.6	-30.1	-15.2
Shërbim	-5.2	-8	-8.8	-3.7
Ndërtim	-3.5	-3.9	-6.2	-3.7
Prodhim	-9.1	-11.2	-17.4	-8.4
Transport	-1.4	-1.8	-1.8	-1.1
Total	-38.5	-48.5	-64.3	-32.1

Tabela me TVSH sipas sektoreve 5 mujor 2010-2011

Lloji i të Ardhurave	Periudha 05 - MUJORE			
	FAKTET		Diferenca 2011 - 2010	
	2010	2011	+ ose -	Përqindje
T. V. SH.-ja gjithsej	11,903,874	10,508,543	(1,395,331)	-11.7%
Sektori PRODHIMIT	2,872,292	3,320,991	448,699	15.6%
Sektori NDËRTIMIT	3,304,157	2,207,044	(1,097,113)	-33.2%
Sektori TRANSPORTIT	149,348	185,864	36,515	24.4%
Sektorit TREGTISË	1,804,802	1,819,256	14,454	0.8%
Sektori SHËRBIMEVE	3,773,275	2,975,389	(797,886)	-21.1%

Ecuria e TVSH në periudhën Janar - Maj dhe krahasimi me 2010

TVSH Doganë 2011	(miliardë lekë)	Në % ndaj Planit	Në % ndaj 2010
Janar-Maj	33.6	-8.8%	3.5%
TVSH Tatime 2011	(miliardë lekë)	Në % ndaj Planit	Në % ndaj 2010
Janar-Maj	10.5	-29.0%	-11.7%

TVSH 5 mujor	2008	2009	2010	2011
TVSH (miliardë lekë)	40.7	42.4	44.4	44.1
% e ndryshimit vjetor	21.6	4.1	4.7	-0.6

Taksa doganore

Të ardhurat nga taksa doganore për periudhën Janar - Maj janë rreth 2.7 miliardë lekë, 10.6 përqind më pak se parashikimi; krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2010, të ardhurat nga kjo taksë janë rritur me 113 milionë lekë, ose 4.3 përqind. Niveli mesatar i taksës doganore për këtë periudhë është 1.74 përqind, i njëjti nivel me 2010. Të ardhurat nga taksa doganore janë ndikuar kryesisht nga rritja e vlerës së importeve për periudhën në fjalë.

Akciza

Të ardhurat gjithsej nga Akciza për periudhën Janar - Maj arritën në rreth 13.4 miliardë lekë; ose 2.3 miliardë lekë më pak se parashikimi; krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2010, të ardhurat nga kjo taksë janë 4.5 % më të ulta ose 626 milionë lekë më pak. Akciza pësoi ndryshime të ndjeshme në qershor të vitit 2010: u ul akciza mbi kafën e papjekur (nga 70 lek në 30 lek për kg), u hoqën nga lista e mallrave me akcizë lëngjet e frutave dhe pijet freskuese; në grupin e nënprodukteve të naftës shtohet artikulli "naftë virgin" me nivel akcize 50 lek për litër; u shtuan në listën e mallrave me akcizë: fishekszjarret, gomat, pilat dhe bateritë primare, ambalazhet; ndryshoi taksimi i llampave inkandeshente nga ad valorem në shumë fikse. Në fund të vitit 2010 pati rritje të akcizës mbi cigaren, nga 50 lekë në 70 lekë për paketë.

Ajo që bie në sy është rënia e të ardhurave nga akciza që mbledhin Doganat me 14.8 përqind kundrejt një viti më parë dhe 18.2 përqind më pak se parashikimi. Doganat mbledhin akcizën e karburantit të importuar dhe të birrës së importuar, si dhe të mallrave të tjerë që nuk taksohen me anë të pullës së akcizës (sic janë mallrat që i janë shtuar listës). Sipas llojit të mallrave kryesore me akcizë, situata e zhdoganimeve për periudhën ka qënë si vijon: sasia e karburanteve të zhdoganuar për periudhën Janar - Maj 2011 është 129 mijë ton, me rënie vjetore 25 përqind; sasia e cigareve të zhdoganuara për periudhën Janar - Maj 2011 është 1000 ton, me rënie vjetore prej 30 përqind, si pasojë e shtimit të importeve në muajt e fundit të 2010, para hyrjes

në fuqi të rritjes së akcizës; sasia e birrës së zhdoganuar për periudhën Janar – Maj 2010 është 9.6 milionë litra, me një rënie prej 11 përqind, e ndikuar nga rritja e prodhimit vendas të këtij artikulli; kafeja e zhdoganuar për periudhën ka qënë 32 përqind më shumë.

Nga administrata tatimore janë mbledhur nga akciza rreth 6 miliardë lekë, me rritje vjetore 12.1 përqind. Tatimet mbledhin akcizën mbi cigaret dhe pijet alkoolike përveç birrës, përmes pullës së akcizës, si dhe akcizën e karburantit të prodhuar në vënd (ARMO). Në tabelën në vijim pasqyrohen të dhënat e të ardhurave sipas mallrave vendi/importi për pesëmujorin e 2011 dhe krahasimi me 2010.

Të ardhurat nga akciza sipas mallrave

Të ardhura, miliardë lekë	5 mujor 2010	5 mujor 2011	Ndryshimi %
Akciza mbi cigaret	4	3.8	-5%
Akciza karburante vendi	1.2	2	166%
Akciza karburante importi	7.8	6	-23%
Akciza pije alkoolike vendi	0.2	0.26	-
Akciza pije alkoolike importi	0.4	0.4	-

Ecuria e tatimit në muaj dhe krahasimi me 2010

Akciza Dogane 2011	(miliardë lekë)	Në % ndaj Planit	Në % ndaj 2010
Janar-Maj	7.4	-18.2%	-14.8%
Akciza Tatime 2011	(miliardë lekë)	Në % ndaj Planit	Në% ndaj 2010
Janar-Maj	6	-9.9%	12.1%

Taksimi direkt

Tatimi mbi të ardhurat personale

Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale arritën në 11.2 miliardë lekë, me rritje 8.3 përqind në krahasim me 5-mujorin e një viti më parë.

Sipas burimit të të ardhurave, të ardhurat nga tatimi mbi pagën e të punësuarve të sektorit publik kanë qënë rreth 3.6 miliardë lekë, me një rritje vjetore prej 6 përqind; të ardhurat nga tatimi mbi pagën në sektorin jo-publik kanë qënë 3.7 miliardë lekë me rritje vjetore prej 13.4 përqind, c'ka tregon rritje të indikatorit "ëage bill", i cili ndikohet nga niveli i punësimit dhe niveli i pagave, që implikon për një ecuri në rritje të punësimit dhe/ose të produktivitetit në vënd; të ardhurat nga interesat për periudhën janë në nivelin 1.2 miliardë lekë, pak a shumë në të njëjtin nivel me një vit më parë.

Të ardhurat nga taksimi individual sipas burimit të të ardhurave

Të ardhura, miliardë lekë	5 mujor 2010	5 mujor 2011	Ndryshimi %
Paga sektori publik	3.4	3.6	6
Paga sektori jo publik	3.3	3.7	13.4
Interesa	1.2	1.2	1.6
Dividendë	0.18	0.26	40.8
Shitje pasuri e paluajtshme	0.98	0.89	-9.4
Të tjera	1.44	1.55	7.6

Të ardhurat nga TAP sipas sektorëve për pesëmujorin e 2010-2011

Tatimi I të ardhurave personale	(Miliardë lekë)	(Miliardë lekë)	(Miliardë lekë)	(Miliardë lekë)
TAP	12-mujori 2008	12-mujori 2009	12-mujori 2010	5-mujori 2011
Tregëti	3.7	3.2	3.9	1.5
Shërbim	15.7	19.6	18.2	7.7
Ndërtim	1.3	1.4	1.2	0.44
Prodhim	3.6	2.5	3.3	1.3
Transport	0.35	0.35	0.36	0.18
Total	24.7	27	27	11.1

Tatimi mbi të ardhurat nga biznesi

Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin për 5-mujorin 2011 arritën në rreth 10 miliardë lekë nga 7.5 miliardë të mbledhura një vit më parë, me një rritje prej 33.8 përqind. Sipas sektorëve, rezultoi një rritje prej më shumë se 300% të pagesës së tatimit fitimit nga sektori i prodhimit, rritje prej 4.4% nga sektori i shërbimeve dhe rritje prej 2.2% nga ai i tregtisë. Ndërsa me pagesë më të ulët se një vit më parë rezultojnë sektorët e ndërtimit me një ulje prej 14.8% dhe ai i transportit me një ulje prej 8.5%.

Në total, rritja e subjekteve tatimpagues të këtij tatimi për 5-mujorin është 2,381 njësi më shumë se një vit më parë. Në mënyrë të theksuar janë rritur subjektet tatimpagues të tatim

fitimit në shërbime me 136.5% duke sjellë kështu dhe një konkurrencë në treg dhe si pasojë dhe uljen e marzhit të fitimit për sektorin e shërbimeve.

Tatimi mbi fitimin rezulton me tejkalim edhe kundrejt parashikimit për periudhën me 1.5 miliardë lekë ose 19 përqind.

Në tabelën në vijim është ecuria e tatimit mbi fitimin dhe TAP për periudhën Janar-Maj dhe krahasimi me 2010.

Tatimi mbi Fitimin 2011	(miliardë lekë)	Në % ndaj Planit	Në % ndaj 2010
Janar-Maj	10	19%	33.8
TAP 2011	(miliardë lekë)	Në % ndaj Planit	Në % ndaj 2010
Janar-Maj	11.2	5%	8.3

Të ardhurat nga taksa vendore mbi biznesin e vogël arritën në 1.4 miliardë lekë, me rritje vjetore prej 0.6 përqind.

Taksimi i pasurisë

Për qëllime analize, këtu përfshijmë tatimin mbi ndërtesat, mbi tokën bujqësore dhe taksën e kalimit të pasurisë së paluajtshme. Është prej kohësh një pjesë problematike e sistemit tatimor, përse i takon të ardhurave të mbledhura kundrejt të ardhurave potenciale që mund të mblidhen nga pasuria e paluajtshme. Administrimi dhe grumbullimi i taksës mbi pasurinë rezulton të jetë përgjithësisht efektiv përse i përket bizneseve dhe institucioneve / organizatave dhe ndjek të njëjtën tendencë në arritjen e nivelit të parashikuar të të ardhurave me taksat dhe tarifatat e tjera të aplikueshme nga njësitë vendore (tarifat e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit). Ndërkohë, eksperiencia nuk është e njëjtë për kategorinë "Familjare" të taksapaguesve. Këtu tendenca në grumbullimin e kësaj takse është e ulët, dhe njësitë e qeverisjes vendore kanë mjaft probleme në administrim dhe në detyrimin për pagimin e taksës. Për nivelin ende të lartë të informalitetit, ka mjaft vështirësi në vlerësimin e bazës së taksueshme, për arsye të mangësive në deklarimin real të pasurive. Për 5-mujorin taksat mbi pasurinë arrijnë në 958 milionë lekë, ose 2.8 përqind më të ulëta se një vit më parë. Në totalin e të ardhurave tatimore në Shqipëri ky grup taksash zë vetem 0.7 përqind, kundrejt 6 përqind që është mesatarja e vendeve të OSBE.

Taksat nacionale

Të ardhurat nga taksat nacionale në total për periudhën, janë 8 miliardë lekë nga 7.2 miliardë lekë të parashikuara për periudhën Janar - Maj. Duke e krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, të ardhurat nga ky grup taksash kanë pësuar një rritje prej 24.1 përqind.

Të ardhura të tjera nga pushteti vendor

Të ardhurat e mbledhura nga taksat vendore për periudhën Janar - Maj arritën në 6 miliardë lekë nga 6.4 miliardë lekë të planifikuara në buxhetin 2011, ndërsa kundrejt 5-mujorit të parë të

vitit 2010 të ardhurat janë ulur me 232 milionë lekë (rreth 4 përqind). Të ardhurat nga taksat e tjera vendore (pa taksën e biznesit të vogel dhe taksat mbi pasurinë të përmendura më lart) ishin rreth 3.6 miliardë lekë nga 1.1 miliarde të parashikuara, me rritje 7.5 përqind më shume se vitin e kaluar.

Të ardhurat e fondeve speciale

Të ardhurat në fondet speciale për periudhën Janar - Maj 2011 arritën në 23.5 miliardë lekë, me një rritje prej 5 përqind kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë dhe 2.3 përqind me pak se parashikimi. Ky grup të ardhurash përbën rreth 18 përqind të të ardhurave tatimore gjithsej për këtë periudhë. Nga totali i fondeve speciale, 22.7 miliardë lekë janë kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 815 milione leke të ardhura për kompensimin në vlerë të pronareve.

Nga sigurimet shoqërore janë mbledhur 20.6 miliardë lekë, me rritje vjetore prej 9.4 përqind; nga sigurimet shëndetësore janë mbledhur 2 miliardë lekë, 30 përqind më pak se 5-mujori i një viti më parë. Përsa i takon bazës së taksueshme, nga të dhënat paraprake të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për periudhën 5-mujore rezultojnë se: në total ka një rritje të numrit mesatar të të punësuarve për efekt të derdhjes së kontributeve (sektori shtetëror dhe sektori privat) prej 7.58 përqind, ose rreth 28.7 mijë njësi (kontribues), kundrejt mesatares 5-mujore të 2010.

EMERTIMI	Numri mesatar mujor Kontribuesve për periudhën 05-Mujore:			
	FAKTET		Diferenca 2011 - 2010	
	2010	2011	+ ose -	Përqindje
D. P. TATIMEVE GJITHSEJ	378,946	407,674	28,728	7.58%
Sipas sektorëve ekonomikë:	0	0	0	(0)
Spektori Prodhimit	70,309	74,895	4,586	6.52%
Spektori Ndërtimit	30,375	31,007	632	2.08%
Spektori Transportit	15,595	16,442	847	5.43%
Spektori Tregtisë	59,689	68,225	8,536	14.30%
Spektori Shërbimeve	202,978	217,105	14,127	6.96%


Të ardhurat sipas klasifikimit ekonomik

	EMERTIMI	5 Mujor 2010 mld lekë	5 Mujor 2011 mld lekë	%
	TË ARDHURAT NË BUXHETIN E KONSOLIDUAR	128.7	129.8	+0.9
A	Të ardhura tatimore	113.5	119.0	+4.8
I	Tatimet mbi të ardhurat	15.9	17.7	11.3
<i>I.1</i>	<i>Tatimi mbi të ardhurat personale, nga i cili:</i>	<i>10.4</i>	<i>11.2</i>	<i>+7.7</i>
	Tatimi mbi pagën në sektorin publik	3.4	3.6	+5.9
	Tatimi mbi pagën në sektorin jopublik	3.3	3.7	12.1
	Tatimi mbi të ardhurat nga interesat	1.2	1.2	-
	Tatimi mbi të ardhurat nga dividendët	0.2	0.3	+50
	Tatimi mbi të ardhurat nga shitja e pasurisë	1.0	0.9	-10
	Të tjera	1.4	1.6	+14.3
<i>I.2</i>	<i>Tatimi mbi të ardhurat nga biznesi</i>	<i>8.9</i>	<i>11.9</i>	<i>+33.7</i>
	Tatim fitimi	7.5	10.5	+40
	Taksa mbi biznesin e vogël	1.4	1.4	-
II	Të ardhurat në fondet speciale	22.4	23.5	+4.9
III	Taksimi i pasurisë	0.98	0.95	-3.1
IV	Taksat indirekte mbi mallrat dhe shërbimet	58.4	57.6	-1.4
IV.1	Tatimet mbi shitjen	44.4	44.2	-0.5
	TVSH mbi shitjet brenda vendit	11.9	10.5	-11.8
	TVSH mbi mallrat e importuara	32.5	33.7	+3.7
IV.2	Akcizat	14.0	13.4	-4.3
	Mbi karburantet	9.0	8.0	-11.1
	Mbi alkoolin dhe nënproduktet e tij	0.6	0.7	+16.6
	Mbi duhanin dhe nënproduktet e tij	4.0	3.8	-5.0
	Të tjera (kafe, etj)	0.4	0.9	+125
VI	Të tjera taksa mbi mallra dhe shërbime (nacionale)	6.4	8.0	+25.0
	Renta minerare	0.95	1.9	+100
	Taksat mbi kazinotë dhe lojrat e fatit	2.0	2.1	+5.0
	Taksa e qarkullimit rrugor	1.8	1.7	-5.6
	Të tjera	1.7	2.3	+35.2
VII	Taksat doganore	2.6	2.7	+3.8
VIII	Të tjera taksa lokale	4.3	4.5	+4.7
B	Të ardhura jo tatimore, nga të cilat:	13.9	9.9	-28.8
	Tarifa shërbimesh	1.0	1.5	+50
C	Grante	1.4	0.9	-35.7

ANALIZA E SHPENZIMEVE PËR PERIUdhËN JANAR – MAJ 2011**Vështrim i përgjithshëm**

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, në fund të muajit maj 2011, arritën në rreth 150.5 miliardë lekë, nga rreth 153.2 miliardë lekë të parashikuara për këtë periudhë, duke u realizuar në rreth 98.2 përqind të parashikimit të periudhës ose me një mosrealizim prej rreth 2.7 miliardë lekë. Krahasuar me planin vjetor, këto shpenzime janë realizuar në rreth 36.8 përqind, ndërsa kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë, shpenzimet buxhetore rezultojnë rreth 13.2 miliardë lekë më shumë ose rreth 9.6 përqind më të larta. Ecuria e shpenzimeve buxhetore në shumë absolute, ritmi i rritjes së tyre gjatë pesëmuajorëve të parë, në disa vite, si dhe ritmi linear i rritjes, jepet në grafikun e mëposhtëm:

Shpenzimet e përgjithshme janar-maj në vite



Shpenzimet e përgjithshme sipas elementëve kryesore përbërës të tyre, realizuar gjatë periudhës janar-maj 2000-2011, në milionë lekë, jepen në tabelën e mëposhtme:

SHPENZIMET NE VITE 5-MUJORI I PARE

ne milion lekë

	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
TOTALI I SHPENZIMEVE	57,235	64,524	66,684	72,128	76,898	83,010	76,322	86,499	105,683	140,885	137,311	150,538
I. Shpenzime Korrente	48,348	53,265	57,717	63,520	68,385	73,304	69,954	76,958	87,291	103,916	111,626	122,323
1 Personeli	12,530	15,100	15,381	16,756	18,290	20,344	20,585	21,058	24,700	24,299	26,642	27,312
2 Interesat	12,016	10,389	10,241	12,622	13,030	11,052	10,072	10,067	12,359	13,816	15,679	15,095
3 Shpenzime Operative Mirembajtje	6,301	5,456	6,760	7,976	8,116	8,738	6,390	7,857	7,856	10,793	10,784	13,285
4 Subveconet	1,196	3,273	3,823	1,596	1,627	1,367	838	926	700	1,069	522	2,165
5 Shpenzime per Sig.Sociale	11,670	13,627	15,243	17,124	19,172	21,240	22,864	26,555	28,624	36,615	40,141	44,365
6 Buxheti lokal	1,425	2,160	3,156	4,411	4,642	6,436	5,361	6,253	8,222	11,402	10,959	12,299
7 Shpenzime te tjera	3,210	3,260	3,113	3,035	3,508	4,127	3,844	4,242	4,830	5,922	6,899	7,802
II. Shpenzime Kapitale	8,468	11,067	8,967	8,608	8,513	9,706	6,368	9,541	16,984	36,885	25,685	28,215
1 Financimi Brendshem	4,139	5,578	4,409	4,555	4,465	5,455	4,221	7,431	8,262	32,853	20,838	22,675
2 Financimi Huaj	4,329	5,489	4,558	4,053	4,048	4,251	2,147	2,110	8,722	4,032	4,847	5,540

Në analizën e shpenzimeve për periudhën janar-maj 2011 duhet mbajtur parasysh fakti se në realizimin faktik të tyre, janë përfshirë edhe shpenzimet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave dhe nga fondi i kontigjencës për ruajtjen e deficitit. Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, i planifikuar në 1.5 miliardë lekë për vitin 2011, deri në fund të muajit maj është


ekzekutuar në rreth 1.2 miliardë lekë, përkatësisht rreth 205.0 milionë lekë për shpenzime për paga, rreth 320.4 milionë lekë për shpenzime të tjera korrente dhe rreth 645.7 milionë lekë për investime.

Fondi i kontigjencës për ruajtjen e deficitit, i planifikuar në rreth 3.6 miliardë lekë, deri në fund të muaji maj është përdorur në rreth 1.1 miliardë lekë në formën e subvencionit, për kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e pajisjeve fiskale dhe taksimetrave, tek njësitë e qeverisjes vendore.

Shpenzimet Korrente

Shpenzimet korente në fund të muajit maj 2011, kanë arritur në rreth 122.3 miliardë lekë ose rreth 103.6 përqind të parashikimit të periudhës, duke rezultuar me një tejkalim prej rreth 4.3 miliardë lekë. Krahasuar me planin vjetor këto shpenzime janë realizuar në rreth 38.1 përqind, ndërkohë që krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, këto shpenzime rezultojnë rreth 10.7 miliardë lekë më të larta ose rreth 9.6 përqind më shumë.


Shpenzimet korente janar-maj



Shpenzimet e Personelit

Brenda shpenzimeve korente, shpenzimet e personelit, që përfaqësojnë rreth 22.3 përqind të totalit të shpenzimeve korente të realizuara gjatë periudhës janar-maj 2011, rezultojnë rreth 10.1 përqind më shumë se parashikimi i periudhës. Kundrejt planit vjetor këto shpenzime në fund të muajit maj janë realizuar në rreth 39.3 përqind të tij, ndërkohë që krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë shpenzimet e personelit rezultojnë rreth 670 milionë lekë më të larta, ose rreth 2.5 përqind më shumë.

Shpenzimet për personelin janar-maj




Shpenzimet për paga janë në të njëjtën kohë rreth 2.6 përqind më të larta se një vit më parë ose rreth 601 milionë lekë më shumë se një vit më parë, ndërkohë që shpenzimet për sigurimet shoqërore janë rreth 69 milionë lekë më shumë ose rreth 1.9 përqind më të larta, se një vit më parë.

Shpenzimet për Interesa

Shpenzimet për interesa që përfaqësojnë rreth 12.3 përqind të totalit të shpenzimeve korente të realizuara gjatë periudhës janar-maj 2011, rezultojnë me një kursim prej rreth 1.5 miliardë lekë, rrjedhë kjo e kursimit për rreth 1.2 miliardë lekë në interesat e brendëshme dhe rreth 315 milionë lekë në interesat e jashtme. Kundrejt planit vjetor interesat janë realizuar në rreth 31.6 përqind, ndërsa krahasuar me një vit më parë ato rezultojnë rreth 584 milionë lekë më të ulta ose rreth 3.7 përqind më pak. Ecuria e shpenzimeve për interesa gjatë pesëmuajve të parë, në vite jepet nga grafiku i mëposhtëm:


Shpenzimet për interesa janar-maj



Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes

Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes gjatë periudhës janar-maj 2011 arritën në rreth 13.3 miliardë lekë duke qënë rreth 1.8 miliardë lekë mbi nivelet e parashikuara. Kundrejt planit vjetor këto shpenzime janë realizuar në rreth 40.3 përqind të tij. Në të njëjtën kohë ato rezultojnë rreth 2.5 miliardë lekë më të larta se një vit më parë ose rreth 23.2 përqind më të larta.

Shpenzimet O&M janar-maj



Shpenzimet për Subvencione

Shpenzimet për subvencione në fund të muajit maj 2011 arritën në rreth 2.2 miliardë lekë ose rreth 1.6 miliardë lekë më shumë se parashikimi. Këtu duhet marrë parasysh edhe fakti i përmendur më sipër se rreth 1.1 miliardë lekë janë dhënë me vendime të Këshillit të Ministrave, në formën e subvencionit, për kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e pajisjeve fiskale dhe taksimetrave, tek njësitë e qeverisjes vendore.

Shpenzimet për Fonde Speciale


Shpenzimet për fonde speciale gjatë periudhës janar-maj 2011 rezultojnë rreth 1.4 miliardë lekë më pak apo rreth 3.0 përqind nën nivelin e parashikimit të periudhës. Kjo situatë është rrjedhojë e mosrealizimit prej rreth 2.1 miliardë lekë të shpenzimeve për sigurimet shoqërore, e rreth 592 milionë lekë tejkalim në shpenzimet për sigurimet shëndetësore dhe e rreth 176 milionë lekë tejkalim në shpenzimet për kompensimin e ish pronarëve. Kundrejt planit vjetor shpenzimet për fondet speciale janë realizuar në nivelin 38.0 përqind, nga të cilat sigurimet shoqërore janë realizuar në rreth 38.5 përqind të planit vjetor, sigurimet shëndetësore në rreth 38.6 përqind dhe shpenzimet për kompensimin e pronarëve në rreth 45.3 përqind të këtij plani.

Krahasuar me një vit më parë shpenzimet për sigurimet shoqërore rezultojnë rreth 2.4 miliardë lekë më të larta ose rreth 7.9 përqind më shumë, ndërsa shpenzimet për sigurimet shëndetësore rezultojnë rreth 902 milionë lekë më të larta, ose rreth 9.3 përqind më shumë.

Shpenzime të Pushtetit Lokal

Shpenzimet e pushtetit vendor zënë rreth 10.1 përqind të shpenzimeve korrente. Për periudhën janar- maj 2011 ato kanë arritur në rreth 12.3 miliardë lekë nga rreth 11.6 miliardë lekë të planifikuara për këtë periudhë të vitit 2011, duke rezultuar me një tejkalim prej rreth 711 milionë lekë ose rreth 6.1 përqind më shumë se plani i periudhës. Kundrejt planit vjetor këto shpenzime kanë arritur në rreth 38.7 përqind të tij. Krahasuar me një vit më parë këto shpenzime rezultojnë rreth 1.3 miliardë lekë më të larta ose rreth 12.2 përqind më shumë. Ecuria e shpenzimeve të pushtetit vendor për periudhën janar-maj për disa vite jepet nga grafiku i mëposhtëm.

Shpenzimet për pushtetin lokal janar-maj




Pagesa e Papunësisë

Pagesa e papunësisë është realizuar në rreth 89.2 përqind të parashikimit të periudhës, duke qënë rreth 32.6 përqind e parashikimit vjetor dhe në të njëjtën kohë rreth 57 milionë lekë më pak se viti i kaluar ose rreth 13.7 përqind më pak se në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Ndihma ekonomike gjatë periudhës janar-maj 2011 rezulton rreth 336 milionë lekë më shumë ose rreth 5.4 përqind mbi parashikimin e periudhës, duke qënë në të njëjtën kohë rreth 38.1 përqind e planit vjetor. Kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë ndihma ekonomike rezulton rreth 0.9 përqind më e lartë ose rreth 60 milionë lekë më shumë.

Shpenzimet për mbrojtjen sociale janar-maj




Shpenzimet Kapitale

Shpenzimet kapitale deri në fund të muajit maj 2011 janë realizuar në nivelin 84.8 përqind të parashikimit të periudhës ose në rreth 34.2 përqind të planit vjetor. Këtu duhet të mbahet parasysh se rreth 645.7 milionë lekë janë dhënë nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për investime Brenda këtyre shpenzimeve, investimet me financim të brendshëm janë realizuar në masën 50.5 përqind, ndërkohë që investimet me financim të huaj janë realizuar në masën 14.8 përqind të parashikimit vjetor.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar investimet e brendshme rezultojnë rreth 1.8 miliardë lekë më të larta ose rreth 8.8 përqind më shumë, ndërkohë që investimet me financim të huaj rezultojnë rreth 693 milionë lekë më të larta ose rreth 14.3 përqind më shumë. Për rrjedhojë, investimet në total në fund të muajit maj 2011 janë rreth 9.9 përqind më të larta ose rreth 2.5 miliardë lekë më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Shpenzimet kapitale janar-maj



Struktura e investimeve kapitale të realizuar gjatë periudhës janar-maj 2011 është rreth 80.4 përqind nga financimi i brendshëm dhe rreth 19.6 përqind nga financimi i huaj.